4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

Në rrugën e integritit në BE, Shqipëria po përfron legjislacionin veterinar me standartet evropiane, lidhur me vendosjen në treg të produkteve me origjinë shtazore të sigurta për konsumatorin. Në këtë kontekst, kontrolli veterinar i kafshëve të gjalla dhe produkteve blegtorale lidhet ngushtë me matrikullimin e kafshëve dhe kontrollin e lëvizjes së tyre.

OBJEKTIVAT

Objektivi është të krijohet një sistem operativ, për matrikullimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale në të gjithë teritorin e vendit, të rritet kontrolli i lëvizjes së kafshëve, sigurimin e informacionit për popullatën e kafshëve për të mundësuar planifikimin e masave profilaktike veterinarë, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të kafshëve.

PËRSHKRIMI I PUNËS

Reforma në shërbimin veterinar konsiderohet si një nga prioritetet e strategjisë së përgatitur nga MBZHR. Ngritja dhe mbajtja e një sistemi kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale është baza për arritjen e këtij objekti.

I. Identifikimi i kafshëve **të llojit gjedh** parashikon furnizimin me:

- Matrikuj plastik, individuale për gjedhë: dy për kafshë (çift, një në secilin vesh);
- Pasaporta e kafshës, që shoqëron matrikujt (një për kafshë);

Lista e mallrave që kërkohen

	Emertimi	Sasia Copë
A	Matrikuj për gjedhe dhe pasaporta e kafshës (*)	
1	Matrikuj çift (për dy veshë, shoqëruar me pasaportë)	223,300

A - Matrikujt për gjedhin

Kafshët do të identifikohen me matrikuj në përputhje me sistemin kombëtar të identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale.

Mallrat duhet të shoqërohen me dokumentacion, rezultate të provave, raporte vlerësimi të laboratorëve profesionale, për të vërtetuar përputhjen me kërkesat teknike sipas pikave të mëposhteme të shënuar me (*)

Nr.	Emërtimi	Destinacioni	Sasia/ Copë
1	Matrikuj gjedhi	AKVMB	
	Specifikime të përgjithshme		
	• Matrikujt kanë dy pjesë: mashkull/femer.		
	• Matrikujt duhet të jenë të pa fallsifikueshëm dhe të kenë vetëm informacionin e përshkruar më poshtë në pjesën “Shkrimi mbi matrikull”.		
	<u>Mireqënia e kafshëve</u>		

	<ul style="list-style-type: none"> • Gjatë vendosjes në vesh, matrikulli nuk shkakton shqyerje, plagë, inflamacion apo iritrim permanent. • Fiksimi i matrikullit në vesh nuk shkakton mbetje të lëkurës apo qimeve në vrimën e hapur. 	
	<p><u>Materiali(*)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Matrikulli është material plastik fleksibël, që reziston gjatë gjithë jetës së kafshës (Jo më pak se 10 vjet); gjatë kësaj periudhe të jetë i lexueshem, dhe i pazmontueshëm në lidhje. • Matrikulli të plotësojë karakteristikat si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - Elasticitet i lartë në temperatura nga -20° deri +50° C. - Rezistencë ndaj faktorëve të jashtëm: ndaj hidrolizes, ndaj rrezeve ultra-violet, nuk ndryshon ngjyrë, i reziston mikrobeve. - Nuk shkakton alergji apo reagime të tjera që mund të kenë efekt negativ në mbylljen e plagës, dhe nuk lejon akumulimin e pa-pastërtive. - Nuk duhet të përmbajë ndotje dhe duhet të jetë material i ripërpunueshëm (riciklueshëm). - Ngjyra e verdhë. • <u>Lidhja mashkull/femër nuk shqyhet pas fiksimit (*)</u> <ul style="list-style-type: none"> - Maja e pjesës “mashkull” është e mprehtë dhe e fortë me material metalik, për të shpuar lehtësisht veshin e një kafshe adulte. Ajo është prej materiali metalik i rezistueshëm ndaj korrozionit dhe e lidhur fort me trupin e pjesës “mashkull”. - Materiali i majës shpuese nuk shkakton inflamacionin e veshit në vendin e shpimit. - Gjatësia e pjesës shpuese të mos pengojë rritjen normale të veshit. - Të dy pjesët (mashkull/femër) rrotullohen në pikën e lidhjes. “Rrotullimi” nënkupton që pjesët mund të rrotullohen me dorë pa përdorur mjete të tjera. - Matrikulli i vendosur nuk mund të hiqet nga veshi i kafshës pa thyer pikën e lidhjes. • <u>Stampimi(*)</u> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi mbi matrikull nuk mund të fshihet më fërkim apo me solvent, dhe është lehtësisht i lexueshëm. - Shkrimi mbi matrikull ka garancinë të jetë i lexueshëm për të paktën 10 vjet. - Shkrimi mbi matrikull bëhet me lazer. • <u>Material i ri-ciklueshem(*)</u> Matrikulli është Mono-material. • Përdorim me lehtësi <ul style="list-style-type: none"> - Pjesët mashkull/femër të matrikullit duhet të vendosen lehtësisht në darën e matrikullimit. Nuk duhet të ketë mundësi për vendosje të gabuar të pjesëve në darë. <p>Madhësia e matrikullit pjesa femër</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lartësia: 60 mm 	

- Gjerësia: 75 mm
- Trashësia: 1-2 mm
- Pesha maksimale jo më shumë se 6 gram.

Madhësia e matrikullit pjesa Mashkull

- Gjerësi: 60 mm
- Lartësia: 55mm
- Trashësia: 1-2 mm
- Pesha maksimale jo më shumë se 4.5 gram

Hapësira mashkull femër të jetë 10 mm.

Pjesa mashkull me kokë metalike.

Forma e matrikullit

- Trapezoidale

Shkrimi mbi matrikull

- Muaji dhe viti i prodhimit të shkruhen pa ngjyrë.
- Matrikujt e të dy veshëve duhet të kenë të njëjtin informacion të shkruar.
- Pjesët mashkull/femër të matrikullit duhet të kenë të njëjtin informacion të shkruar.

Mbi matrikull çift (në dy veshë) shkruhen:

- Logo e Republikës së Shqipërisë
- Logo e prodhuesit (pa ngjyrë)
- “AL” kodi i vendit

Kodi individual i kafshës me 8 numra nga të cilët:

- Kodi i Rrethit me 2 numra, dhe
- Kodi i kafshës me 6 numra

Shkrimi mbi matrikull përgatitet nga pala kontraktuese në një skedë elektronike me një format të miratuar. Detajet do të propozohen dhe konfirmohen nga AKVMB , para fillimit të prodhimit të matrikujve.

Kërkesat e paketimit

Secila kuti për matrikujt çift duhet të përmbajë minimumi 400 matrikuj (200 çifte matrikujsh për matrikullimin e 200 kafshëve)

Në secilën kuti të shënohet: Kodi i rrethit i shkruar mbi matrikull + numri progresiv i kutisë; numri i matrikullit te parë te kutisë, numri i matrikullit të fundit të kutisë
Fituesi i tenderit duhet të furnizojë një skedë elektronike me kodet e kutive dhe listën e matrikujve që përmban secila kuti.
Kjo skedë duhet të ketë strukturën e mëposhtme

	<p>Secila kuti për matrikujt tek duhet të përmbajë minimumi 400 matrikuj (400 teke matrikujsh për matrikullimin e 400 kafshëve)</p> <p>Në secilën kuti të shënohet: Kodi i rrethit i shkruar mbi matrikull + numri progresiv i kutisë; numri i matrikullit të parë të kutisë, numri i matrikullit të fundit të kutisë</p> <p>Fituesi i tenderit duhet të furnizojë një skedë elektronike me kodet e kutive dhe listën e matrikujve që përmban secila kuti. Kjo skedë duhet të ketë strukturën e mëposhtëme</p> <p>Kodi i kutise: C 4 Fillon nga matrikulli me numër: C 10 Mbaron me matrikullin me numër: C 10 Ndarja me (;) shembull:</p> <table border="1" data-bbox="300 779 742 936"> <tr><td>0101;AL01000001;AL01000200</td></tr> <tr><td>0102;AL01000201;AL01000400</td></tr> <tr><td>0103;AL01000401;AL01000600</td></tr> <tr><td>.....</td></tr> </table>	0101;AL01000001;AL01000200	0102;AL01000201;AL01000400	0103;AL01000401;AL01000600	
0101;AL01000001;AL01000200						
0102;AL01000201;AL01000400						
0103;AL01000401;AL01000600						
.....						
2	<p>Pasaporta e kafshës Shtypur në letër të verdhë që peshon të pakten 120 gr/m² Formë kuadrate, dimensione 14,5x10 cm Të jenë të shtypura emri i rrethit dhe kodi i kafshës (kodi i shkruar mbi matrikullin që shoqëron kjo pasaportë)</p>					

II. SPECIFIKIME TË PËRGJITHESHME (TE IMTA)

Në rrugën e integritimit në BE, Shqipëria po përafron legjislacionin veterinar me standartet evropiane. Në këtë kontekst, kontrolli veterinar i kafshëve të gjalla dhe produkteve blegtorale lidhet ngushtë me matrikullimin e kafshëve dhe kontrollin e lëvizjes së tyre.

Objektivat

Objekivi është të krijohet një sistem operativ për matrikullimin e kafshëve, të bagëtive të imta dhe regjistrimin e fermave blegtorale në gjithë teritorin e vendit te rritet kontrolli i lëvizjes së kafshëve, sigurimin e informacionit për popullatën e kafshëve për të mundësuar planifikimin e masave profilaktike veterinare, kontrollin dhe çrënjosjen e sëmundjeve infektive të kafshëve.

PERSHKRIMI I PUNES

Reformimi i shërbimit veterinar konsiderohet si një nga prioritetet e strategjise së përgatitur nga MBZHR. Ngritja e një sistem kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale është baza për arritjen e këtij objekivi.

Identifikimi i bagëtive të imta parashikon furnizimin me:

- Matrikuj plastik, individuale për të imtat: dy për kafshë (çift, një në secilin vesh);
- Matrikuj plastik, individuale për të imat: një për kafshë (tek, për një vesh)

Lista e mallrave që kërkohen

	Emertimi	Sasia copë
A	Matrikuj për të imtat kafshë për remont dhe darë për matrikullim (*)	
1	Matrikuj çift (remont) për dy veshë	394,500
2	Matrikuj tek(për një vesh)	9,000

Kërkesat teknike për matrikuj të imtash

Kafshët do të identifikohen me matrikuj në përputhje me sistemin kombëtar të identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale.

Matrikujt duhet të shoqërohen me dokumentacion, rezultate të provave, raporte vlerësimi të laboratorëve profesional, për të vërtetuar përputhjen me kërkesat teknike sipas pikave të mëposhtme të shënuar me (*)

Nr .	Emërtimi	Destinacioni	Sasia/ Copë
1	Matrikuj të imtash	AKVMB	
	<p>Specifikime të përgjithëshme</p> <ul style="list-style-type: none"> Matrikujt kanë dy pjesë: mashkull/femër. Matrikujt duhet të jenë të pa fallsifikueshëm dhe të kenë vetëm: informacionin e përshkruar më poshtë në pjesën “Shkrimi mbi matrikull” <p><u>Mirqënia e kafshëve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Gjatë vendosjes në vesh, matrikulli nuk shkakton shqyerje, plagë, inflamacion apo irritim permanent. Fiksimi i matrikullit në vesh nuk shkakton mbetje të lekurës apo qimeve në vrimën e hapur. <p><u>Materiali(*)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Matrikulli është material plastik fleksibël, që reziston gjatë gjithë jetës së kafshës (të paktën deri në 8 vjet); gjatë kësaj periudhe të jetë i lexueshëm, dhe i pazmontueshëm në lidhje. Matrikulli të plotësojë karakteristikat e mëposhtme: Elasticitet i lartë në temperatura nga -20° deri +50° C. Rezistencë ndaj faktorëve të jashtëm: ndaj hidrolizës, ndaj rrezeve ultra-violet, nuk ndryshon ngjyrë, i reziston mikrobeve Nuk shkakton alergji apo reagime të tjera që mund të kenë efekt negativ në mbylljen e plagës, dhe nuk lejon akumulimin e pa- 		

pastërtive.

- Nuk duhet të përmbajë ndotje dhe duhet të jetë i ripërpunueshëm
- Ngjyra e verdhë.

Lidhja mashkull/femër nuk shqyhet pas fiksimit (*)

- Maja e pjesës “mashkull” është e mprehtë dhe e fortë me material metalik, për të shpuar lehtësisht veshin e një kafshe adulte. Ajo është prej materiali metalik që i reziston korrezionit dhe e lidhur fort me trupin e pjesës “mashkull”.
- Materiali i majës shpuese nuk shkakton inflamacionin e veshit në vendin e shpimit.
- Gjatësia e pjesës shpuese të mos pengojë rritjen normale të veshit.
- Të dy pjesët (mashkull/femër) rrotullohen në pikën e lidhjes. “Rrotullimi” nënkupton që pjesët mund të rrotullohen me dorë pa përdorur mjete të tjera.
- Matrikulli i vendosur nuk mund të hiqet nga veshi i kafshës pa thyer pikën e lidhjes.

Stampimi(*)

- Shkrimi mbi matrikull nuk mund të fshihet me fërkim apo me solvent, dhe është lehtësisht i lexueshëm.
- Shkrimi mbi matrikull ka garancinë të jetë i lexueshem për 8 vjet.
- Shkrimi mbi matrikull bëhet me lazer.

Material i ri-ciklueshëm(*)

- Matrikulli është Mono-material.
Përdorim me lehtësi
- Pjesët mashkull/femër të matrikullit duhet të vendosen lehtësisht në darën e matrikullimit. Nuk duhet të ketë mundësi për vendosje të gabuar të pjesëve në darë.
- Pjesët femër mashkull të rrotullohen me lehtësi pas matrikullimit .
- Pjesa mashkull të ketë kokë të mbyllur.
Madhësia e matrikullit .
- Madhësia për të dy pjesët, femra dhe meshkuj, duhet të jetë e njëjtë.
- Matrikulli duhet të jetë i dizajnuar në mënyrë të njëjtë si për të leshta dhe për të dhirta.
- Të përshtatshëm për përdorim si për të leshtat e të dhirtat.
- Dizajni; Iloj Buttoni (i rrumbullaket) diametër 27 mm
- Trashësia: 1-2 mm për secilën pjesë.
- Pësia maksimale e të dyja pjesëve së bashku jo më shumë se 6 gram.

Shkrimi mbi matrikull

- Muaji dhe viti i prodhimit të shkruhen pa ngjyrë.
- Pjesët mashkull/femër të matrikullit duhet të kenë të njëjtin informacion të shkruar.

Mbi matrikull për remont shkruhen:

- Logo e Republikës së Shqipërisë
- Logo e prodhuesit (pa ngjyrë)
- “AL” kodi i vendit
- Kodi individual i kafshës me 8 numra nga të cilët:
- Kodi i Rrethit me 2 numra, dhe
- Kodi i kafshës me 6 numra

Kërkesat për shtypjen e matrikujve

- Matrikujt për vesh duhet të shtypen me ngjyrë të verdhë që është qartazi e dukshme gjatë gjithë kohës të jetës së kafshës.
- Nuk duhet të jetë mundësia e heqjes së informacionit mbi matrikullin e veshit nga gërryerja ose nga përdorimi i tretësve.
- mbishkrimi mbi matrikull duhet të jetë i garantuar të paktën për 8 vjet pra informacioni mbi matrikull nuk duhet të shuhet.
- Mbishkrimi mbi matrikullin të jetë shtypur me lazer
- Lartësia e karaktereve të shtypura duhet të jetë të paktën 4 mm
- Cilësia e printimit të verifikohet duke përdorur testin Taber për të cilën provat e dokumentuara duhet të furnizohen .

- Detajet e kodeve të qarkut dhe numrat e etiketave të rretheve, do të furnizohen për të ofertuesit fitues para furnizimit
- Shkrimi mbi matrikull përgatitet nga pala kontraktuese në një skedë elektronike me një format të miratuar. Detajet do të propozohen dhe konfirmohen nga AKVMB, para fillimit të prodhimit të matrikujve.

Kërkesat e paketimit

- Secila kuti duhet të përmbajne minimumi 100 matrikuj (50 çifte matrikujsh për matrikullimin e 50 kafshëve).
- Këto kuti duhet të jenë të paketuara në kuti më të mëdha që të përmbajnë minimumi 1000 matrikuj pra të kenë 10 pako me 100 matrikuj secila .
- Matrikujt e secilit vesh duhet të jenë pranë njëri-tjetrit ose të ndara në një fletë që lidhen me njeri tjetrin

Kushtet teknike

Ofertuesi duhet të sigurojë një skedar elektronik me të gjitha kodet kuti dhe listën e kodeve të matrikujve të përfshira në çdo kuti.

Fituesi i tenderit duhet të dorëzojë një skedë elektronike me kodet e kutive dhe listen e matrikujve që përmban secila kuti.

.SPECIFIKIME TE PERGJITHESHME DERRA (DOSA DHE PARADOSA DHE DERRA PËR THERJE).

Në rrugën e integritimit në BE, Shqipëria po përafrohet legjislativisht me standartet europiane. Në këtë kontekst, kontrolli veterinar i kafshëve të gjalla dhe produkteve blegtorale lidhet ngushtë me matrikullimin e kafshëve dhe kontrollin e lëvizjes së tyre.

OBJEKTIVAT

Objektivi është të krijohet një sistem operativ për matrikullimin e kafshëve, dosave, paradosave dhe derrave për therje dhe regjistrimin e fermave blegtorale në të gjithë territorin e vendit.

PERSHKRIMI I PUNES

Reformimi i shërbimit veterinar konsiderohet si një nga prioritetet e strategjisë së përgatitur nga MBZHR. Ngritja e një sistemi kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale është baza për arritjen e këtij objekti.

Identifikimi i kafshëve të llojit derr parashikon furnizimin me:

- Matrikuj plastik, individuale për (dosa dhe paradosa) dy për kafshë (çift, një në secilin vesh);
- Matrikuj plastik, individuale për derra për therje: një për kafshë (tek, në një vesh);

Lista e mallrave që kërkohen

	Emertimi	Sasia copë
A	Matrikuj për derrat (dosa dhe paradosat) dhe darë për matrikullim (*)	
1	Matrikuj çift (dosa dhe paradosa) për dy veshë	10,400
2	Matrikuj tek për një vesh (derra për therje)	4,400

Shënim: matrikujt për matrikullimin e derrat (dosa, paradosa dhe derra për therje), janë të njëjtë me matrikujt për të imtat me përjashtim të ngjyrës që është jeshile.

Kërkesat teknike për matrikuj derra (dosa, paradosa dhe derra për therje)

Kafshët do të identifikohen me matrikuj në përputhje me sistemin kombëtar të identifikimit dhe regjistrimit të fermave blegtorale.

Matrikujt duhet të shoqërohen me dokumentacion, rezultate të provave, raporte vlerësimi të laboratorëve profesionale, për të vërtetuar përputhjen me kërkesat teknike sipas pikave të mëposhtme të shënuar me (*)

Nr.	Emertimi	Destinacioni	Sasia/ Copë
1	Matrikuj për derra (dosa dhe paradosa dhe derra për therje)	AKVMB	

Specifikime të përgjithshme

- Matrikujt kanë dy pjesë: mashkull/femer.
- Matrikujt duhet të jenë të pa fallsifikueshëm dhe të kenë vetëm informacionin e përshkruar më poshtë në pjesën “Shkrimi mbi matrikull”

Mirqënia e kafshëve

- Gjatë vendosjes në vesh, matrikulli nuk shkakton shqyerje, plagë, inflamacion apo irritim permanent.
- Fiksimi i matrikullit në vesh nuk shkakton mbetje të lekurës apo qimeve në vrimën e hapur.

Materiali (*)

- Matrikulli është material plastik fleksibël, që reziston gjatë gjithë jetës së kafshës (të paktën deri 8 vjet); gjatë kësaj periudhe të jetë i lexueshëm, dhe i pazmontueshëm në lidhje.
- Matrikulli të plotesojë karakteristikat e mëposhtëme:
- Elasticitet i lartë në temperatura nga -20° deri +50° C.
- Rezistence ndaj faktorëve të jashtëm: ndaj hidrolizes, ndaj rrezeve ultra-violet, nuk ndryshon ngjyrë, i reziston mikrobeve
- Nuk shkakton alergji apo reagime të tjera që mund të kenë efekt negativ në mbylljen e plagës, dhe nuk lejon akumulimin e papastërtive.
- Nuk duhet të përmbajë ndotje dhe duhet të jetë i riperpunueshëm
- Ngjyra jeshile.

Lidhja mashkull/femer nuk shqyhet pas fiksimit (*)

- Maja e pjesës “mashkull” është e mprehtë dhe e fortë me material metalik, për të shpuar lehtësisht veshin e një kafshe adulte. Ajo është prej materiali metal që nuk korrodohet dhe e lidhur fort me trupin e pjesës “mashkull”.
- Materiali i majës shpuese nuk shkakton inflamacionin e veshit në vendin e shpimit.
- Gjatësia e pjesës shpuese të mos pengojë rritjen normale të veshit.
- Të dy pjesët (mashkull/femer) rrotullohen në pikën e lidhjes. “Rrotullimi” nënkupton që pjesët mund të rrotullohen me dorë pa përdorur mjete të tjera.
- Matrikulli i vendosur nuk mund të hiqet nga veshi i kafshës pa thyer pikën e lidhjes.

Stampimi(*)

- Shkrimi mbi matrikull nuk mund të fshihet me fërkim apo me solvent, dhe është lehtësisht i lexueshëm.
- Shkrimi mbi matrikull ka garancinë të jetë i lexueshëm për 8 vjet.
- Shkrimi mbi matrikull bëhet me lazër.

Material i ri-ciklueshëm(*)

- Matrikulli është Mono-material.

Përdorim me lehtësi

- Pjesët mashkull/femër të matrikullit duhet të vendosen lehtësisht në darën e matrikullimit. Nuk duhet të ketë mundësi për vendosje të gabuar të pjesëve në darë.

Madhësia e matrikullit .

- Madhësia (për të dy pjesët, femra dhe meshkuj, duhet të jetë e njëjtë.
- Matrikulli duhet të jetë i dizajnuar në mënyrë të njëjtë për dosat.
- Të përshtatshëm për përdorim për derra.
- Dizajni: lloj Butoni (i rrumbullaket) diametër 25-30mm
- Trashësia: 1-2 mm, për secilën pjesë.
- Peshë maksimale jo më shumë se 6 gram.

Shkrimi mbi matrikull

- Muaji dhe viti i prodhimit të shkruhen pa ngjyrë.
- Pjesët mashkull/femër të matrikullit duhet të kenë të njëjtin informacion të shkruar.

Mbi matrikull për remont (cift në dy veshë) shkruhen:

-Logo e Republikës së Shqipërisë

- Logo e prodhuesit (pa ngjyrë)

“AL” kodi i vendit

Kodi individual i kafshës me 8 numra nga të cilët:

- Kodi i Rrethit me 2 numra, dhe
- Kodi i kafshës me 6 numra

Mbi matrikull për therje (tek në një vesh) shkruhen:

-Logo e Republikës së Shqipërisë

- Logo e prodhuesit (pa ngjyrë)

“AL” kodi i vendit

Kodi individual i kafshës me 6 numra nga të cilët:

- Kodi i Rrethit me 2 numra, dhe
- Kodi i kafshës me 4 numra që përkon me kodin e fshatit sipas Instatit.

Kërkesat për shtypjen e matrikujve

- Matrikujt për vesh duhet të shtypen me ngjyrë jeshile që është qartazi e dukshme gjatë gjithë kohës të jetës së kafshës.
- Nuk duhet të jetë mundësia e heqjes së informacionit mbi matrikullin e veshit nga gërryerja ose nga përdorimi i tretësve.
- mbishkrimi mbi matrikull duhet të jetë i garantuar për 8 vjet pra informacioni mbi matrikull nuk duhet të shuhet.
- Mbishkrimi mbi matrikullin të jetë shtypur me lazer.

- Lartësia e karaktereve të shtypura duhet të jetë të paktën 4 mm.
- Cilësia e printimit të verifikohet duke përdorur testin Taber për të cilën provat e dokumentuara duhet të furnizohen.

- Detajet e kodeve të qarkut dhe numrat e etiketave të rretheve, do të jepen ofertuesit fitues para furnizimit.
- Shkrimi mbi matrikull përgatitet nga pala kontraktuese në një skedë elektronike me një format të miratuar. Detajet do të propozohen dhe konfirmohen nga AKVMB , para fillimit të prodhimit të matrikujve.

Kërkesat e paketimit

- Secila kuti me matrikuj për dosa dhe paradosa çift në të dy veshët duhet të përmbajnë minimumi 100 matrikuj (50 çifte matrikujsh për matrikullimin e 50 kafshëve).
- Secila kuti me matrikuj për therje tek në një vesh, duhet të përmbajnë minimumi 100 matrikuj (100 tek matrikujsh për matrikullimin e 100 kafshëve).
- Këto kuti duhet të jenë të paketuara në kuti më të mëdha që të përmbajnë minimumi 1000 matrikuj pra të kenë 10 pako me 100 matrikuj secila.
- Matrikujt e secilit vesh duhet të jenë pranë njëri-tjetrit ose të ndara në një fletë që lidhen me njëri tjetrin.

Kushtet teknike

Ofertuesi duhet të sigurojë një skedar elektronik me të gjitha kodet kuti dhe listën e kodeve të matrikujve të përfshira në çdo kuti.

Fituesi i tenderit duhet të dorëzojë një skedë elektronike me kodet e kutive dhe listën e matrikujve që përmban secila kuti. Matrikujt për dosa, paradosa dhe derra për therje, janë të ngjashëm me matrikujt e të imtave me përjashtim të ngjyrës që është jeshile.

Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Matrikuj çift (për dy veshë, shoqëruar me pasaportë) ,Gjedh	copë	223,300
2	Matrikuj çift (remont) për dy veshë.Imta	copë	394,500
3	Matrikuj tek(për një vesh).Imta	copë	9,000
4	Matrikuj çift (dosa dhe paradosa) për dy veshë.Derrat	copë	10,400
5	Matrikuj tek për një vesh (derra për therje).Derrat	copë	4400

Afatet e lëvrimit: Brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet

të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/skeda teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikullin e ofruar, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme, e cila përfshin objektin e prokurimit), si më poshtë si më poshtë:

- SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 45001 “Sisteme të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punët” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë ICAR (Komiteti Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve) të prodhuesit, të vlefshme, për matrikujt e Gjedit.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat në formën finale të produktit që do të levrohet si më poshtë:

-Matrikuj për gjedh: një copë me matrikuj në formën që do të levrohet malli. Matrikulli duhet të jetë në formën dhe permasat e kerkuara si dhe të përmbajë të gjithë elementet e stampuara sic kërkohej në specifikimet teknike.

-Matrikuj për të imta: një cope me matrikuj në formën që do të levrohet malli. Matrikulli duhet të jetë në formën dhe permasat e kerkuara si dhe të përmbajë të gjithë elementet e stampuara sic kërkohej në specifikimet teknike.

-Matrikuj për derra (dosa dhe paradosa): një copë me matrikuj në formën që do të levrohet malli. Matrikulli duhet të jetë në formën dhe permasat e kerkuara si dhe të përmbajë të gjithë elementet e stampuara sic kërkohej në specifikimet teknike.

Skedari i matrikujve nuk zëvendëson mostren që mostren që do të paraqitet.

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet OBP-së, në adresën "Rruga "Reshit Çollaku", Godina Nr.6/377, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)"

Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, përmes së cilës merr përsipër shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi pranë ambienteve të autoritetit kontraktor përfitues brenda afatit të parashikuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">• Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

